



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:291011

Datë: 13.03.2024

Numri i dokumentit: 05448655

P.nr.978/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL gjyqtari i vetëm gjykues Refki Piraj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Arbnijë Gashi, në lëndën penale, kundër të pandehurit B.D., nga fshati Krajk, Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 parag. 8 lidhur me par. 6 dhe par. 1, i Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore Prizren PP/II. nr. 2022-4/2021, të datës 20.09.2022, pas mbajtës së shqyrtimit fillestar, në praninë e Prokurores së Shtetit Merita Kurtishi Gaka, të dëmtuarit E.D., të pandehurit B.D., dhe mbrojtësit të tij av. A.B., me datë 06.02.2024 mori, ndërsa me datë 06.03.2024 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B.D., nga i ati dhe e ëma, mbiemri i vajzërisë së nënës, i lindur me datë, në fshatin Krajk, Komuna e Prizrenit, i martuar, punëtor, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 08.08.2021, rreth orës 11:00 h, në fshatin Krajk, Komuna Prizren, i pandehuri B.D., duke e drejtuar automjetin e markës “.....”, me targa sllovene, vepron në kundërshtim me nenin 53 par.(1) të Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, ashtu që si rrjedhojë e pakujdesisë së tij, duke lëvizur me veturë në mënyrë të pasigurt dhe duke mos e përshtatur shpejtësinë kushteve dhe rrethanave të rrugës, në një moment e humb kontrollin e veturës dhe bartet në anën e majtë të rrugës, ku për fillim i godet disa lisa dhe në pamundësi që të ndalet, me pjesën ballore e godet murin e oborrit të një shtëpie, ku si pasojë e këtij aksidenti, përveç dëmeve materiale, pasagjeri i kësaj veture E.D., pëson plagë shqyese ndrydhëse në regjionin e majtë të fytyrës, thyerje të kockës së krahut të majtë, ndrydhje në indeve të buta në regjionin e hundës, të shkaktuar si rezultat i veprimit mekanik të mjetit të fortë, që si të tilla bëjnë pjesë në lëndime të rënda trupore me pasoja të përkohshme të shëndetit, sipas akt ekspertizës mjekoligjore të Dr. N.U., dt. 08.12.2021.

-Me këto veprime ka kryer veprën penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 parag. 8 lidhur me par.6 dhe par. 1 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 17, 23, 38, 39, 40, 43, dhe 69, të KPRK-së dhe nenin 242 e neneve 364 dhe 365 të KPRK-së të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej treqind (300) euro, të cilin duhet ta paguaj, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me të holla nuk mund të paguhet nga ana e të akuzuarit në afatin ligjor, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, duke llogaritur njëzet (20) euro, për një (1) dite burgim, gjegjësisht 15 ditë burgim.

Të dëmtuarin E.D., nga fshati Krajk, Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i pandehuri që ti paguajë te gjitha shpenzimet e procedurës penale, në bazë të llogarisë se gjykatës, në emër te paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20,00 euro, në emër të ekspertizës së komunikacionit shumën prej 150.00 euro, në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumën prej 20.00 euro, në zbatim të ligjit mbi mbrojtjen e viktimave të krimit të akuzuarit i caktohet taksa në shumën prej 20,00 euro, të cilat është i obliguar ti paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nën kërcenim të ekzekutimit të dhunshëm.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën PP/II. nr. 2022-4/2021, të datës 20.09.2022, ndaj të pandehurit B.D., nga fshati Krajk, Komuna e Prizrenit, për shkak te veprës penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragraf 8 lidhur me paragraf 6 dhe paragraf 1, i Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovës (KPRK),.

Gjykata me datën 06.02.2024 ka caktuar shqyrtimin fillestar, ku i akuzuari pas udhëzimeve lidhur me të drejtat të cilat i takojnë sipas ligjit konform nenit 241 të KPP-së, pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, vullnetarisht, në konsultim me mbrojtësin e tij av. Avni Berisha, e ka pranuar fajësinë për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragraf 8 lidhur me paragraf 6 dhe paragraf 1, i Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovës (KPRK).

Prokurori i shtetit nuk e ka kundërshtuar pranimin e fajësisë pasi ky pranim i fajësisë është bërë në baza vullnetare, pasi i njëjti është bërë në pajtim me dispozitat ligjore të KPP-së, kërkon nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit si rrethanë lehtësuese të merre instituti i pranimit të fajësisë kurse si rrethanë rënduese të merret përgjegjësia e tij penale duke pasur parasysh faktin se këto vepra janë gjithnjë e në rritje, andaj ka kërkuar që të njëjtit të shpall fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I dëmtuari E.D., ka theksuar se këtu të akuzuarin e ka kushëri dhe me këtë rast ndaj të njëjtit nuk parashtrij asnjë kërkesë pasurore juridike dhe kërkoj nga gjykata që të njëjtit meqenëse ka pranuar fajin ti shqipton një dënim sa më të butë.

Mbrojtësi i të akuzuarit avokati A.B., ka theksuar se meqenëse sot në seancën e shqyrtimit fillestar i mbrojturi im B.D., vullnetarisht pranon fajësinë për të cilën akuzohet, se në ditën kritike pa dashje ka ndodhur vetaksident, andaj i propozoj gjykatës që gjatë marrjes dhe shqiptimit të dënimit të ketë parasysh edhe këto rrethana lehtësuese, pranimin e veprës

penale, është hera e parë që bie ndesh me ligjin , premtion gjykatës që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm ndaj këtyre vepra penale, andaj propozoj që ti shqiptohet një dënim sa më i butë.

I akuzuari B.D., ka theksuar se e pranon fajësinë si në aktakuzë.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 241 lidhur me 242 të KPPRK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjykata konstatoi se i akuzuarit e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 244 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Bazuar në pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe konform nenit 241 e 242 të KPPRK-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Gjykata në shqyrtim fillestar nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit dhe provave materiale në shkresat e lëndës si deklaratës së të pandehurit B.D., të dhënë në polici me datë 09.08.2022 dhe në prokurori me dt.31.08.2022, deklaratës së të dëmtuarit E.D., të dhënë në prokurori me dt.16.08.2022, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit rrugor, nga Ing. M.D., dt. 10.09.2022, akt ekspertiza mjeko-ligjore nga Dr. Naim Uka, dt.08.12.2021, foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes, si dhe shikimi në shkresa tjera të lëndës, ka vërtetuar gjendjen faktike sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj kjo gjykatë duke u bazuar në këto që u thanë më lart vërtetoi gjendjen faktike se në veprimet e të akuzuarit, plotësohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 parag. 8 lidhur me par. 6 dhe par. 1, i Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovës (KPRK), prandaj dhe ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitës së nenit 69, të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, pastaj keqardhjen e shfaqur nga i akuzuari si, vepra penale është kryer nga pakujdesia dhe premtimin se do të jetë më i kujdesshëm nuk do të do të bie ndesh me ligjin, si dhe rrethanat personale të të dënuarit se është i moshës së re dhe i gjendjes së dobët ekonomike. Duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me peshën e veprës penale të kryer, me rrethanat personale dhe shkallen e përgjegjësisë të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, e mori në kuptim te nenit 449 dhe 451 të KPP-së.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, e mori në kuptim te nenit 457 të KPP-së.

Vendimi mbi pagesën e taksës në emër të Programit për kompensimin e viktimave të krimit, është marrë në kuptim të nenit 36 par. 3 pika 3.1. të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Më sa u tha më lartë u vendos si ne shqiptim të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2021:291011
Datë: 13.03.2024
Numri i dokumentit: 05448655

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
P.nr.978/2022 i datës 06.03.2024

G j y q t a r i

Refki Piraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.